



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18.12.2025
Kodi i ZRRE-së: V_3007_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Ankesën e konsumatorit në ZRrE të dt. 05.06.2025;
- Rekomandimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK_R_2812_12_25, i dt. 05.02.2025.

në seancën e mbajtur më datë 18.12.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** ankesa e aplikuesit “H Energy SHPK – H. C.”, nga Komuna e Deçanit, si e bazuar.
- II. OBLIGOHET KEDS** që ta pajisë aplikuesin me Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike sipas legjislacionit në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 05.12.2025 ka nxjerrë Rekomandim për Bordin e ZRRE-së me nr. ZRRE/DMK_R_2812_12_25, me të cilin i rekomandon Bordit që të aprovohet si e bazuar ankesa e aplikuesit “H Energy SH.P.K., - H. C.”, dhe të obligohet KEDS që aplikuesin ta pajisë me PEE dhe ZT, sipas legjislacionit në fuqi.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 18.12.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe Rekomandimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se ky Rekomandim si i tillë është i drejtë dhe i bazuar në prova materiale si në shkresat e lëndës.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e konsumatorit në ZRrE e dt. 05.06.2025, Rekomandimin e DMK-së të dt. 05.12.2025, Informatën e KEDS të dt. 20.05.2025, me nr. 6101, Pëlqimin Parimor me nr. 37 e dt. 14.01.2025, Kërkesën për Pëlqim të aplikuesit e dt. 13.01.2025, Certifikatën e Regjistrimit të Biznesit në ARBK e dt. 24.07.2023, Certifikatën e Pronësisë e dt. 15.04.2025, Përshkrimin Teknik të Projektit si dhe provat e tjera materiale si në shkresat e lëndës. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e aplikuesit **është e bazuar**, sepse:



Me datë 13.01.2024, aplikuesi "H Energy" SH.P.K., - G. H. C., ka parashtruar Kërkesë për Pëlqim, tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, për parkun solar "H Energy" SH.P.K., me kapacitet të instaluar nga 1MWp deri në 5MWp sa të ketë kapacitet në rrjetin ekzistues ose trafostacion. Kësaj kërkesë, i ishte bashkëngjitur edhe Projekti – Plan Situacioni dhe skemat njëpolare.

Me datë 14.01.2025, Njësia e Shërbimeve me Konsumatorë në KEDS i ka lëshuar konsumatorit Pëlqimin Parimor me nr. 37, përmes të cilës konsumatori njoftohet që ky pëlqim i lëshohet për rregullimin e dokumentacionit teknik, përmes të cilës, ndër të tjera, konsumatori është udhëzuar që para fillimit të ndërtimit të objektit të aplikoj për kyçje të përkohshme, me afat të vlefshmërisë për një 1 vit nga data e lëshimit dhe se konsumatori brenda këtij afati është obliguar që ta sjellë projektin e objektit për marrjen e PEE-së.

Njësia e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme në KEDS, pasi që e kishte shqyrtuar kërkesën e konsumatorit për kyçje të gjeneratorit me sistem solar për fuqi 1-5MW, me datë 20.05.2025, përmes Përgjigjes me nr. 6101, e kishte njoftuar konsumatorin që kërkesa e tij refuzohet, për shkak se – kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-të në stabilimentet elektroenergjetike, në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht në NS "110/10 kV Deçani" janë të plotësuar. Prandaj, KEDS nuk mund të lejojë kyçje për kapacitete të reja gjeneruese, marrë parasysh kapacitetin akomodues për BRE në këtë zonë.

I pakënaqur me këtë Përgjigje, aplikuesi me dt. 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRë, duke e kontestuar Informatën e KEDS, të dt. 20.05.2025, për arsye se – KEDS nuk ka kryer asnjë analizë të detajuar teknike, pa argumentim inxhinierik të mbështetur në studime të rrjetit dhe pa ofruar rrugë alternative teknike për akomodimin e kapacitetit të kërkuar. Kërkon nga ZRRë që – të aprovohet si e bazuar ankesa e aplikuesit "H Energy SH.P.K.," dhe të detyrohet KEDS në rishqyrtim të kërkesës të aplikuesit dhe t'i ofrojë aplikuesit një Zgjidhje Teknike për realizimin e lidhjes në rrjet.

Aplikuesi ka aplikuar për Pëlqim Elektroenergjetik dhe Zgjidhje Teknike, në Kompaninë Kosovare për Distributim me Energji, dhe kjo duke iu referuar nenit 9 – Aplikimi për Kyçje dhe Oferta e Kyçjes, të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes, si vijon: *"Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo Konsumator Prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike. 2. Procesi i kyçjes për njësitë gjeneruese ose konsumatorëve prodhues është i njëjtë me procesin e kyçjes për konsumatorët fundor".* Më tej, në par. 6 të këtij neni përcaktohet se: *"Në rastet e aplikimeve për kyçje të njësive gjeneruese në rrjetin e shpërndarjes, njësitë gjeneruese të BRE-ve kanë përparësi ndaj atyre konvencionale".*

Pasi që ishte shqyrtuar kërkesa e konsumatorit për PEE dhe ZT, lidhur me kërkesën për kyçjen e gjeneratorit me sistem solar për fuqi 1-5MW, me adresë në Kodrali – Komuna e Deçanit, nga KEDS – Njësia e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme, konsumatori është njoftuar që – "kërkesa juaj aktualisht refuzohet, për shkak se, tani kapacitetet akomoduese për gjenerim nga BRE-të në stabilimentet elektroenergjetike në afërsi të lokacionit të gjeneratorit të propozuar nga ana juaj, konkretisht në NS "110/10 kV Deçani" janë të plotësuar. Prandaj, KEDS nuk mund të lejojë kyçje për kapacitete të reja gjeneruese, marrë parasysh kapacitetin akomodues për BRE-të në këtë zonë. Më



tutje, në këtë Përgjigje, si akt përfundimtar të kuptim të përcaktimeve ligjore të Metodologjisë së Taksave të Kycjes, konsumatori udhëzohet për të drejtën e tij në ankesë në ZRrE.

Bordi thekson se, KEDS me refuzimin e kërkesës së konsumatorit për kyçjen e gjeneratorit, ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse, ka qenë i obliguar që aplikuesit t'i lëshoj Pëlqimin Elektroenergjetik sipas kërkesës së tij, në harmoni me nenin 10 – Refuzimi për Kyçje, të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike si në vijim: *“Operatori i Sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi. 2. Në rast të refuzimit të kyçjes, Operatori i Sistemit lëshon dhe dërgon tek aplikuesi një njoftim në formë të shkruar që paraqet arsyen e refuzimit brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit, përkatësisht brenda afatit përfundimtar të 11/26 përcaktuar në Nenin 9 paragrafi 8 të kësaj Rregulle. 3. Operatori i sistemit do të refuzoj të kyç një aplikues në rast se nuk ka kapacitetet të mjaftueshëm të rrjetit, por nuk do të refuzojë një kyçje për një aplikues mbi bazën që nuk ka gjenerim të mjaftueshëm të lidhur me rrjetin. 4. Operatori i Sistemit nuk ka të drejtë të refuzojë kyçjen e një centrali të ri për arsye të kufizimeve të mundshme të kapaciteteve të rrjetit në dispozicion, siç mund të jetë kongjestioni në pjesët më të largëta të rrjetit, por duhet t'i ofrojë mundësi të kyçjes në pikën më të afërt të mundshme”.*

Po ashtu KEDS ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 51, paragrafi 4 i Ligjit për Energjinë Elektrike e ku potencohet qartë kur refuzohet përkohësisht kyçja dhe atë vetëm kur pajisjet e konsumatorit nuk janë në përputhje me kodet teknike, pra neni 51, paragrafi 4, potencon: *“Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit nuk plotësojnë normat teknike ose kushtet tjera të përshkruara në Kodin e rrjetit të transmetimit dhe Kodin e rrjetit të shpërndarjes”.* Gjithashtu neni 10, paragrafi 9.2.6 i Metodologjisë së Taksave për Kyçje të OSSH, përcakton se OSSH mund të refuzoj të kyçë një Aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike, Rregullës për Kushtet e Përgjithshme, Kodit të Rrjetit dhe Shpërndarjes ose kodeve tjera në fuqi.

Përfundimisht, Bordi se, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura nga OSSH në trajtimin e kërkesës për kyçjen e gjeneratorit nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) në rrjetin e shpërndarjes, konstatohet që, operatori ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat/aktet e tjera rregullatore, për shkak që, konsumatorit nuk i është ofruar një vlerësim teknik i argumentuar, një arsyetim ligjor më i detajuar dhe komunikim brenda afateve të përcaktuara. Refuzimi i paarsyetuar dhe i pambështetur në ekspertizë teknike të verifikueshme përbën shkelje të detyrimeve të operatorit të shpërndarjes dhe krijon pengesa të pajustifikuara për integrimin e kapaciteteve të reja të BRE-ve.

Bordi i ZRRE-së pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët e në veçanti kërkesat e aplikuesit në KEDS, Përgjigjen e KEDS, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të Metodologjisë së Taksave të Kycjes, Ligjit për Energjinë Elektrike, si dhe kodet teknike në fuqi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KEDS;
- Aplikuesit **H Energy SH.P.K., - H. C.,**
- Arkivit të ZRRE-së.